

## AKT THEMELIMI

### Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ORIONIS-ALBANIA ” SH. P. K.

Sot, më datën 14.09.2022, Z, Marjus Çela, e lindur në Durres me datë 25 Shtator 1984 mbajtes i kartës së identitetit me numër 033447732, banuese në Shqiperi , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar vendosi te themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “ORIONIS-ALBANIA ” Sh. P. K. si më poshtë vijon

#### Neni 1

Personi fizik i sipërpërmendur, me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijon shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh. P. K.) me emërtimin “ORIONIS-ALBANIA ”

Ortakë i vetem i kesaj shoqërie eshte Z. Marjus Çela

Administrator i kësaj shoqërie caktohet Z. **Marjus Çela** per nje afat 5 vjecar me te drejte riperteritje.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

#### Neni 2

Shoqëria “ORIONIS-ALBANIA “ gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Sh. P. K.”. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë “ORIONIS-ALBANIA” Sh. P. K. është **Lagja 4, Rruga “Fetah Bllaca” Pallati nr. 1133, zona Kadastrale 8514, Kati i tretë, përballë shkollës “Jusuf Puka” Durres**

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

#### Neni 3

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe te pacaktuar.

#### Neni 4

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

- Agjensi për shërbime imobiliare.
- Agjensi për shërbime turistike



- Shërbime marketingu e ndërmjetësimi.
- Punime ndërtimi e restaurimi .
- Transport kombëtar dhe ndërkombëtar të pasagjerëve, mallrave të çdo lloji me mjetet e veta ose të të tretëve të komunikacionit tokësor dhe detar.
- Projektim arkitektonik
- Import – eksport të mallrave të ndryshëm industrialë të reja dhe të përdorura, mallra të konsumit dhe ushqimorë
- Shërbime administrimi banesa e objekte të ndryshme.
- Shërbime të ndryshme me karakter social

#### **Neni 5**

Kapitali i shoqërisë është 100.000 Leke. Kapitali I shoqërisë ndahet në një numër kuotash në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri ku çdo ortak zoteron një kuote të vetme në shoqëri, kuota këto të shlyera teresisht nga ortaku i vetëm.

Z. **Marjus Çela** zoteron një kuote me vlerë 100.000 leke që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë ( pasuri të luajtshme ose të paluajtshme apo të drejta ).Ortaku i vetëm përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundëjt të treteve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

#### **Neni 6**

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakut të saj.

#### **Neni 7**

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

#### **Neni 8**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

#### **Neni 9**

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesi i kësaj shoqërie, pasi e lexoi me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjeti në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tij, e firmosi pa vërejtje.

---

### **ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË**

**MARJUS ÇELA**

MARJUS ÇELA 